

RREGULLORE NR. 2001/41

**NDRYSHIMI I RREGULLORES SË UNMIKU-ut NR. 2001/11 PËR TATIMIN MBI
VLERËN E SHTUAR NË KOSOVË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për Kosovën të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të datës 25 korrik 1999 mbi Autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë dhe nenin 8.1(ç) të Rregullores së UNMIK-ut 2001/9 të datës 15 maj 2001 mbi Kornizën Kushtetuese të Qeverisjes së Përkohshme në Kosovë,

Pas shpalljes së Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/11 të datës 31 maj 2001 mbi Tatimin e paragjykuar,

Me qëllim të lehtësimit të zbatimit të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/11 për përfundimin e konvertimit nga marka gjermane ("DM") në euro,

Me anë të kësaj Rregulloreje shpall sa vijon:

Neni 1
Ndryshimet e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/11 për Tatimin mbi vlerën e shtuar në Kosovë

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/11 do të ndryshohet si më poshtë:

- (a) Në nenin 3.4, "200.000 DM" do të zëvendësohet me "100.000 euro";
- (b) Në nenin 23.2(b), "10.000 DEM" do të zëvendësohet me "5000 euro"; dhe
- (c) Në nenet 23.3(c), "10.000 DEM" do të zëvendësohet me "7.500 euro".

Neni 2
Ligji në fuqi

Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.

Neni 3
Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të nxjerrë urdhëresa administrative për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 1 janar 2002.

Hans Haekkerup,
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm